



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 21 prill 2015**

**Numri i lëndës: 2014-30**

**Adil Shabani**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 13 maj 2014.

## **II. FAKTET**

### *Procedurat në lidhje me lejen e ndërtimit*

2. Në një datë të pasaktësuar, ankuesi ka paraqitur një kërkesë në Drejtorinë e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Prizrenit, duke kërkuar leje ndërtimi në mënyrë që ta vendos një mur në pronën e tij.
3. Kërkesa e tij ishte hedhur poshtë më 10 korrik 2011.
4. Më 10 tetor 2011, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor hodhi poshtë ankesën e ankuesit ndaj atij vendimi.
5. Ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër vendimit të Ministrisë në Gjykatën Supreme të Kosovës më 15 nëntor 2011.
6. Më 28 gusht 2013, Gjykata Supreme ka informuar ankuesin se prej fillimit të janarit 2013 Gjykata Themelore e Prishtinës ishte kompetente të merrej me rastin e tij.
7. Nuk është e qartë se çfarë ka qenë rrjedha e mëtejshme e procedurës.

### *Procedurat lidhur me privatizimin e kompanisë “Elan”*

8. Ankuesi ishte punonjës i ndërmarrjes shoqërore “Elan” në Prizren, e cila ishte privatizuar në një datë të pasaktësuar në vitin 2009.
9. Më 18 dhjetor 2011, ankuesi ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimi (DHPGJS). Ai ishte ankua se emri i tij nuk ishte përfshirë në listën e ish punëtorëve të “Elan-it”, të cilët kishin të drejtë në 20% e të ardhurave nga shitja e kompanisë së privatizuar.
10. Trupi Gjykoës i DHPGJS-së ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit më 20 qershor 2013.
11. Më 1 korrik 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së.
12. Nuk është e qartë se çfarë ishte rrjedha e mëtejshme e procedurës.

## **III. ANKESAT**

13. Pa u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të dokumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se të dyja procedurat ishin të padrejta. Ai gjithashtu pohon se ka qenë

i diskriminuar në bazë të prejardhjes së tij etnike (ankuesi është boshnjak kosovar).

#### **IV. LIGJI**

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
17. Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lerë më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë mënyrë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit.
18. Si pasojë, çështjet që janë ngritur nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si rrjedhojë, ato bien jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vetë të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (krahasoni *Shaip Gashi* kundër EULEX-it, 2013-20, 26 nëntor 2013 § 9; *Jovanka, Dragan dhe Milan Vukovic* kundër EULEX-it, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12).

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë juridiksionit të tij në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese